



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO
KUVENDI KOMUNAL/ASSEMBLY OF MUNICIPALITY/SKUPŠTINA OPŠTINE
SKENDERAJ

Nr. 01-060/09-0041356/25
Data 17.09.2025



Komuna Skenderaj
Opština Skenderaj
Municipality Skenderaj

Kuvendi i Komunës/Skupština Opštine/Municipality of Assembly

Në bazë të nenit 49, të Ligjit për vetëqeverisje lokale nr. 03/L-040, të Republikës së Kosovës, si dhe nenit 43 të Statutit të Komunës së Skenderajt Nr.01-110-385, të datës 03.12.2008, si dhe Rregulloren e Punës së Kuvendit nenit 27, e në pajtim me rregullat e procedurës.

Ekstrakt nga procesverbali i MBLEDHJES SË KUVENDIT KOMUNAL SKENDERAJ,
i datës 31.07.2025, ora 10:00

Në këtë mbledhje janë diskutuar këto pika:

1. Fjala hyrëse;
2. Miratimi i rendit të ditës;
3. Shqyrtimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluara;
4. Shqyrtimi i Raportit financiar gjashtëmuor janar-qershor 2025, me Nr.04-052/01-0026961/25, të datës 09.07.2025, (Raporton drejtori i DBF-së, **z. Ismet Aliu**);
5. Shqyrtimi i Raportit të Auditimit për Pasqyrat Financiare Vjetore të Komunës së Skenderajt për vitin 2024, me Nr.04-47-1123/1, i datës 26.06.2025, si dhe Plani i veprimit për zbatimin e rekomandimeve të auditorit të jashtëm, me Nr. 04-052/01-0026963/25, i datës 09.07.2025, (Raporton drejtori i DBF-së, **z. Ismet Aliu**);
6. Propozim-vendim për Plotësim ndryshimin e Rregullores Nr. 01-110/01-0025382/22, e datës 06.06.2022, për Taksa, Tarifa, Ngarkesa dhe Gjoha në Komunën e Skenderajt, me Nr.02-110/05-0029514/25, e datës 22.07.2025, (Raporton drejtori i DBF-së, **z. Ismet Aliu**);
7. Propozim-vendim për Themelimin e Poliklinikës Specialistikë në kuadër të QKMF-së në Komunën e Skenderajt, me Nr.02-351/01-0026564/25, të datës 10.07.2025, (Raporton U.d. i Drejtorit të QKMF-së në Skenderaj, **z. Ilir Havolli**);
8. Propozim-vendim për miratimin e raportit përfundimtar, Nr. 09-052/01-0026407/25, i datës 07.07.2025, i hartuar nga komisioni komunal për vlerësimin e dëmeve, si pasojë e fatkeqësive natyrore si (era, zjarri), për periudhën janar-qershor 2025, me Nr.02-052/01-0027799/25, i datës 11.07.2025, Raporton drejtori i DSHP-së **z. Alban Shala**);
9. Pyetjet e këshilltarëve nën pikat të ndryshme.

Kryesuesja e kuvendit, Adelina Spahiu: I nderuar kryetari i komunës, të nderuar anëtar të kuvendit, drejtor të drejtorive, dhe gjithë ju të pranishëm, në sallë janë 27 anëtar, mungon me arsye Azem Gashi, kurse mungon pa arsye Arjeta Rama, dhe bashkëngjiten gjatë mbledhjes Besnik Ahmeti dhe Alketa Mecini.

-Shkojmë me miratimin e rendit të ditës, e hap debatin, nëse nuk ka, shkojmë në votim për Rend dite; Konstatohet me (17) vota për, (11) kundër dhe (0) abstenim, miratohet Rendi ditës.

Vazhdojmë me pikën 3 të rendit të ditës,

-Shqyrtimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluara, e hapë debatin, fjalën ja kaloj;

Hysni Mehani-LVV: Fjala përshëndetëse, me bëri përshtypje tek integriteti juaj si kryesuese e kuvendit dhe mbrojtja e këtij institucioni, që në procesverbal z. Nura të ka urdhërua që pyetjet që i kemi pas në seancën e kaluar mos me i bartë për këtë seancë. Pra me qenë së është u.d. i kryetarit mundet me ushtrua atë detyrë, po jo metë tregua ty çka me bë. Edhe tjetra keni bë dy herë shkelje, ose padrejtësi, sepse ne e kemi lëshua seancën, sepse propozimet tona nuk kanë kaluar edhe

rregullorja thotë që para miratimit të rendit ditës i cili votohet me ngritje dore me shumicën e anëtarëve që janë të pranishme dhe votojnë, 13 votuar për, 12 votuar kundër, dhe 5 abstenim, pra kur të votojnë shumica që janë të pranishëm propozimi kalon, dhe kemi pas drejtë që e kemi lëshua seancën, dhe e kemi marr një veprim që nuk na ka ndodh herëve tjera që mos mi bartë pyetjet, veç të jetë kjo e vërtetuar në procesverbal, si një inati, si një shkelje e pa kuptimtë.

Abdulla Gashi-IDEAL: Fjala përshëndetëse, edhe unë e pata këtë shqetësim me ngritë sa i përket pyetjeve nga seanca e kaluar, fatkeqësisht nuk është njerëzorë as etike ato pyetje mos me kaluar në këtë seancë, dhe kam pas shume pyetje për disa drejtor, dhe disa herë për pyetjet kanë munguar drejtores dhe nuk e keni marr për bazë mungesën e drejtoresve, dhe është e papërgjegjshme ndaj jush.

Kryesuesja; Dikush tjetër, nëse nuk ka, fjalën ja kaloj;

Kryetari i komunës, Fadil Nura: Fjala përshëndetëse, nuk desha me marr fjalën, po me qenë se u diskutua për aspektin njerëzor, etik e moral, po e dha një përgjigje, në rregullore të kuvendit nuk përshkruhet baza pyetjeve, në momentin kur një drejtor mungon, barten pyetjet, po në momentin kur parashtruesi i pyetjes e lëshon seancën për qëllime politike, atëherë nuk e kam urdhëruar, po kam kërkuar, që pyetjet mund të barten po kam të drejtën mos mu përgjigj, sepse nuk është çështje ligjore kjo, kështu që keni pas drejt me i vazhdua të njëjtat pyetje, po me lëshua seancën për çështje politike e me u bartë pyetjet besoj është e pa drejtë e pa justifikuar pa bazë ligjore. Në momentin kur ju vini e nënshkruani e merrni mëditjet e dilni prej seance për çështje politike unë nuk kam kohe me ju pritë e me ju përgjigj këtu, sepse kam punë tjera ma të mençme dhe ma të nevojshme.

Kryesuesja; Replikë 1 min. fjalën ja kaloj;

Abdulla Gashi-IDEAL; Kisha pas dëshire z. Nura të na sqaroni dhe tregoni atë ligj që e ndalon me i bartë pyetjet për dyti herë në seancë qe ne e lëshojmë seancën për çështje morale, dhe unë kam kërkuar me i përsërit pyetjet dhe i kam dërguar, nuk janë përsërit, është turp.

Hysni Mehani-LVV: Për besë është jo i nivelit me bë një devijim çfarë e bënë z.Nura, autoriteti, integriteti i kryesueses do të duhej me qenë vendim i kryesuese jo i kryetarit, se nëse i hime rregullores, statutit thotë së asambleja është instanca me e lartë, dhe kryetari është këtu me dhënë përgjegjësi jo me dhënë urdhra dhe ky është dallimi substancial. Nëse kish qenë që i ka largua kryesuesja në rregull jemi, po si ka largua kryesuesja i ka largua kryetari, e kjo është shkelje e madhe. Kryesuese e përfaqëson institucionin me të lartë të Kuvendit të Komunës, kështu që ta ruajmë integritetin e këtij institucioni.

Kryesuesja: Me kaq mbyllet ky debat, Alketa Mecini është bashkangjitur mbledhjes, shkojmë në votim; Konstatojmë me (17) vota për, (11) kundër dhe (0) abstenim, miratohet Procesverbalit nga mbledhja e kaluar.

Vazhdojmë me piken 4 të rendit të ditës;

-Shqyrtimi i Raportit financiar gjashtëmujor janar-qershor 2025, me Nr.04-052/01-0026961/25, të datës 09.07.2025, (Raporton);

Drejtori i DBF-së, Ismet Aliu: Fjala përshëndetëse, para vetes e keni, Raportit financiar gjashtëmujor janar-qershor 2025, është raport i rregullt sipas ligjit, ky raport përcakton shpenzimet e buxhetit në këtë gjashtë mujorë, si buxhet shtesë në këtë gjashtë mujorë i kemi pas 194,930.63€, të hyra të bartura nga viti i kaluar, dhe tani i kemi në shpenzim gjatë vitit aktual nën menaxhim 20,076,401.63€, ky buxhete në këtë gjashtë mujorë është shpenzuar në 53.92%, në Paga dhe shtesa 51.28%, Mallra dhe shërbime 61.53%, Shërbime komunale 54.79%, Subvencione 61.19%, dhe Shpenzimet komunale 53.49%. Të hyrat komunale janë të realizuara në 42.83%, në Kategorinë e mallrave dhe shpenzimeve janë shpenzuar 1,808,347.03€, po me vendime gjyqësore nga kjo kategori janë shpenzuar 285,925.76€, që 15% e këtij shpenzimi ka ndodhur me vendime gjyqësore.

Projektet kapitale i kemi në fq.10 të planifikuar, të shpenzuar sipas planit, në 53.49%, po 750,751.35€ janë shpenzuar me vendime gjyqësore nga kategoria e projekteve kapitale. Në fq.12 i keni shpenzimet sipas programeve drejtorive dhe zyrave, kush ka pyetje jam këtu për përgjigje.

Kryesuesja; E hape debatin, fjalën ja kaloj;

Afrim Kabashi-NSD: Fjala përshëndetëse, në raport drejtor ke thënë se janë shpenzuar 61.19% të fondit aktual, janë subvencionuar kryesisht programe për bujqësi, a mundesh me na tregua cilat programe janë subvencionua, sepse unë nuk e di që u realizua diçka në bujqësi? Dhe drejtor mos e ke gabim ke thënë: Në përgjithësi shpenzimet e gjithmbarshme komunale janar-qershor 2024 janë 30.91% me të mëdha se ato në vitin 2023, a është ndonjë gabim teknik apo çfarë? Të llojet e shpenzimeve të disa kode kish rritje për 100%, si: Të kodi 13141 para xhepi/mëditje për udhëtime zyrtare jashtë vendi, shuma 2,764.00€. Të kodi 13310 Interneti, shuma 4,560.00€, Të kodi 13445, shërbimet e veçanta konsulentë dhe kontraktore individual, shuma 4,655.97€, Të kodi 13475, sigurimi fizik i objekteve publike, shuma 112,636.16€, Të kodi 14050, mirëmbajtja e mobiljeve dhe pajisjeve, shuma 119,719.70€. ka rritje a mundesh me na tregua drejtor pse këto rritje për vitin 2025 për këtë gjashtë mujor? Të projektet kapitale janar-qershor 2025, të kodi 51210 Nd.kanal Klinë, Prekaz, Turiqec, Polac, Qirez, Runik, Likoc, Rezall shuma 158,183.00€ i realizuar 100%, drejtor po flas për fshatin Polac sene nuk është bërë për kanalizim gjendjen faktike e prezantuar përmes fotove, e me thanë që u realizua diçka, përpos ndriçimit publik në disa pjesë.

Floriana Halili-LVV: Fjala përshëndetëse, Të Zyra e Kryetarit - Kodi 14.310, shuma 5,025€, me shumëzua me 132 ditë punë, që i bie 38€ për ditë dreka zyrtare? Furnizim me ushqim dhe pije: shuma 5,476€ që i bie 41€ në ditë. Shërbime këshilluese e profesionale: shuma 4,620€, që i bie 35€ dita. Derivate për vetura: shuma 4,537€, që i bie 34.37€ dita, pra që i bie afërsisht 30 litra naftë çdo ditë duhet me i shpenzua vetura për me i bërë këto shpenzime. Për me i djeg 30 litra naftë në ditë, një veturë duhet me i bërë rreth 450km, që i bie me qenë 6 orë në lëvizje çdo dite.

A është kjo realisht e mundur për veturën e Kryetarit, kur ai është në zyrë dhe veç për dreka/darka zyrtare e pije janë shpenzua mbi 10,000€? Me i marr 1,122€ para xhepi, dhe me i marr 1,625€ avancë për udhëtime zyrtare jashtë vendit që po i bien, afro 3,000€ para për udhëtime e mëditje. Dhe rrogës mujore e merr afër 1,500€, shpenzime çdo ditë. Pra në total, 240€ në dite i kushton qytetarëve çdo dalje në punë e Kryetarit, për: ushqim, pije, naftë, dreka zyrtare, para xhepi, pra gjitha ato shpenzime përveç rrogës që e merr. Ndërtimi i Urave në Aqarev, Llaush, Kuqic, Tushil, Këto projekte i keni prezantuar sikur janë të juaja - në fakt këto janë projekte të qeverisë, të ndara nga buxheti shtetëror. Dhe ju nuk e keni ndarë asnjë cent nga zyra juaj për këto ura, sepse buxhetin që ju e keni nda për këtë projekt shumen prej 55 mijë euro janë mjete që i kanë nda për vendime gjyqësore. Sinqerisht kemi shume për të folur mbi këtë raport, por kur shifrat maskohen dhe shmangen atëherë gjithë ky proces e humb kuptimin e vetë pra i njëjti model shkelje e vazhdueshme.

Liridona Koca-PDK: Fjala përshëndetëse, me që u përmende Polaci nga kolegu, që tha nuk është punua asgjë, e di që ka nevoja të shumta, po vetëm gjatë kësaj qeverisje është shtruar trotuari ku ka pas nevojë, është bërë ndriçimi publik në pjesën me të madhe të fshatit, disa rrugë janë të trajtuara me zhavor, është përfunduar kanalizimi në lagjen Hoti, Koci, Uka, si dhe në pjesë në lagjen Velu.

Abdulla Gashi-IDEAL: Të kodi 51210 i kanalizimit, ujësjellësit, ndriçimi, Polac, shuma 158,183.00€, çka keni parapa konkretisht, sepse çdo vite jeni tu i bartë këto shifra dhe asnjë rregullim nuk është bërë, as në fshatin Kryshec, Morinë për 4 vite sa është kjo qeveri. Të ndriçimi në Kryshec na ka anashkalua vetëm pjesën e lagjes ku jam unë e kanë ndaluar, këtu ka qëllime politike. Në fsh. Polac kanalizimi në shume pjesë është i pa kyçur, po ashtu edhe në fshatin Dashec nuk është rregulluar kanalizimi, dhe kisha kërkuar nga ju a do të jetë pjesë e buxhetit në vitin 2025.

Hysni Mehani-LVV: Drejtor, një pyetje, Vlera e investimeve kapitale është 4,652,517.64€, për 6 muaj ju i keni realizua veç 1,737,802.63€, e 750,751.35€ i kanë marr vendimet gjyqësore, sa është mundësia me na marr deri në fund të vitit prej projekteve kapitale vendimet gjyqësore? Edhe nëse i ki veç 1,737,802.63€, të realizuara për 6 muaj, a i bjen që kritika për mungesë të buxhetit nuk qëndron, a kanë këto dy sqarime?

Kryesuesja: Fjalën ja kaloj;

Drejtori i DBF-së, Ismet Aliu: Po përgjigjem në disa pyetje të mallra dhe shërbime, për projekte kapitale përgjigjen drejtoret sipas drejtorive. Komuna jonë në kategorinë e mallrave dhe shërbimeve gjatë vitit aktual i ka 2,938,809.99€ të planifikuar deri në fund të vitit, dhe janë shpenzuar 1,808,347.03€, reflektim ka pas pjesa e vendimeve gjyqësore që janë shpenzuar 285,925.76€ nga kjo kategori. Të kodi 13445, shërbimet e veçanta konsulentë dhe kontraktore individual është një shpenzim që jemi të obliguar për shqyrtimin e konkurseve që merr pjesë dikush nga shoqëria civile dhe nga ky kodë është paguar edhe komiteti i auditimit. Të vendimet gjyqësore, të projektet kapitale janë shpenzuar sipas planit 1,737,802.63€, dhe nga vendimet gjyqësore janë 750,751.35€. mjete shtesë nuk pritet të kemi në këtë vite dhe ky është një buxhete që do të menaxhohet deri në fund të vitit.

Drejtori i DUMA-së, Driton Mulaj: Afrim sa i përket kodit 51210 kanalizimet në BL. në kuadër të këtij kodi është punua kanalizimi të Qitakt, Pemisht, Qubrel, Vojnik, të Kompleksi në Marinë, në qytet nën stacion të Policisë. Sa i përket kodit 54319 ndërtimi i urave në Aqarev, Llaushë, Kuqic, është nënshkruar në memorandum me ministrin me datën 30.05.2024 krejt ky projekt i parasheh 150mijë€, mi pagua ministria, 780mijë€ është krejt projekti i urave, vitin e kaluar janë punua dy ura në Klladerrnic, Kuqic, dhe ura madhe ka përfundua në Tushil këtë vite. Sa i përket kanalizimit në Polac jemi tu punua sa të kemi mundësi buxhetore është në kod buxhetor. Sa i përket kanalizimit në Dashec është kryer kanalizimi ana e djathtë e rrugës, rreth dy km, dhe ka mbete pjesa ka pompa, po jo kyqjet nuk janë parapa.

Kryesuesja: Replikë 1 min.

Afrim Kabashi-NSD: Besoj që jetën time me inate politike nuk flasë, Liridona me se pakti kam qejf me ty me debatua se të kam bashkëfshatarë, dhe pyetjet ja kam bërë ekzekutivit edhe kam dëshirë me marr përgjigje nga ekzekutivi. Buxhetin e kam votuar për arsye se buxheti është i qytetarëve nuk është as i Afrim Kabashi as i Fadil Nures dhe as i askujt. Përpos ndriçimit publik nuk është bërë asgjë në Polac, unë nuk e di ku u punua trotuar as asfalt do zhavorr u shtrua.

Abdulla Gashi-IDEAL: Drejtor Driton Mulaj sa i përket çështjes së kanalizimit në fsh.Dashec fatkeqësisht u punua shume pak, edhe në seancat e kaluar u diskutua çështja e kanalizimit në fshatin Dashec. Sa i përket ujit të pijes që është jetik ju keni deklaruar disa herë këtu se do të fillojmë vitin e kaluar dhe ende nuk është bërë asgjë për ujin e pijes, në Burojën e Hashim Thaçit që 4 vite nuk po mundeni me i dal në skaje, ku është problemi, a doni me vazhdua sivjet apo vitin e ardhshëm? Për DSHP, sa i përket ndriçimit publik a ka mundësi me na tregua sa përqind në nivel të komunës së Skenderajt është bërë instalimi i ndriçimit publik? Edhe përse nuk përfundohet gjithë fshati komplet e disa lagje nuk i përfundojnë? Dhe të mbeturinat e kemi rritë çmimin e tarifës e tash që 3 javë nuk kryhen shërbimet, perse?

Hysni Mehani-LVV: Drejtor a po na tregon çka ka ndodh me qeto 55mijë€, ti ka marr qeveria, qeto ura kush ti ka ndërtua, se krejt ma ke pështjell?

Kryesuesja: Fjalën ja kaloj;

Drejtori i DUMA-së, Driton Mulaj: Abdulla kanalizimi në fsh.Dashec ka qenë mbi 33mijë€, ka qenë mbi 2 km vitin 2023 nuk ka qenë e planifikuar në kontratë me përfundua komplet Dasheci, dhe nuk ka përfundua komplet kanalizimi në Dashec. Hysni sa i përket 55mijë€ ndërtimi i urave

me memorandum bashkëpunimi me ministrin, po 55 mijë€ i ka marr përmbaruesi me vendime gjyqësore.

Kryetari i Komunës, Fadil Nura: Për mua është interesante një asamblistë që e ka marr besimin dhe jeton në atë fshatë dhe thotë nuk është punuar asgjësi p.sh. Fsh. Polac, po ti numëroj disa projekte që janë punuar në fsh. Polac si: Ndriçimi, Trotuari në rrugën regjionale, Trotuari prej shkollës deri të lagjja Velu, Kanalizimi në lagjen Velu që u kanë problem që 10 vite, kanalizimi lagjja Hoti, Koci, i kemi përgatit degëzimet për asfalt. Komuna jonë ka paguar mbi 4milion€ për kontratat kolektive e për komunën janë shume. Të ndriçimi publik diskutimi që e kemi pas ka qenë me përfundua krejt fshati jo lagje lagje, pikërisht për këtë mos me u irritua banoret. Në Morinë është investuar në rrugë ndriçimi, ujësjellësi është kyqë, tash e ka në menaxhim ujësjellësi, po furnizimi më ujë nga Mitrovica është i dobët është një sistem i vjetër para 60 viteve dhe nuk ka mundësi të furnizohet me shume dhe aj projekt gjendet në sirtarët e ministrisë.

Kryesuesja: Fjalën ja kaloj;

Floriana Halili-LVV: z.Mula të rregullimi i subqenderes ne Runik kur e keni bërë rregullimin e saj, edhe qysh po ju duket juve rregullim se di a keni qenë ju me pa, veç rregullim nuk është? Edhe lloqin në fsh. Kopiliq sa e keni pagua?

Kryesuesja: Fjalën ja kaloj:

Drejtori i DUMA-së, Driton Mulaj: Floriana, përrurimi i saj u bë dikun ne ora 12:00, u kanë edhe ministri juaj ne takim edhe mas 2-3 muajve janë ardhur inspeksioni i trashëgimisë kulturës kanë ndërpre projektin vitin e kaluar e kemi rifilluar prapë para 3 muajve, dhe në atë zonë nuk kemi drejtë me prek sene.

Kryesuesja: Fjalën ja kaloj:

Hysni Mehani-LVV: Për vendime gjyqësore z. Nura tha janë paguar 4milion €, të instituti GAP thotë në vitin 2024 janë 2,400.000.00€, vitin tjetër 54mijë€, edhe 750mijë€ që i shtojë knej, a po na tregon pjesën tjetër ka i more?

Abdulla Gashi-IDEAL: Kryetar tregona çka u punua në fshatin Kryshec, Morinë, gjatë mandatit të juaj, ti lajmë ato të varrezat,?

Naser Bajraktari-IDEAL: Kryetar elektrifikimin nuk e keni përfundua në as një fshat komplet, p.sh. në fsh. Klinë e Epërme në atë lagje ku jam unë nuk është krye, është përfundua veç në qendër të Klinës së Epërme deri të drejtori.

Kryesuesja: Fjalën ja kaloj:

Kryetari i Komunës, Fadil Nura: z.Gashi me fillim te mandatit i kemi përfundua dy degëzime që i kemi gjete me prioritet në lagje, ndriçimin, në Morinë kemi intervenua në shkollë, në ujësjellës dhe në krahin ka Polaci e kemi përfundua kanalizimin.

Kryesuesja: Me kaq mbyllet ky debat, shkojmë në votim, Konstatojmë me (17) vota për, (10) kundër dhe (0) abstenim përkrahët Shqyrtimi i Raportit financiar gjashtëmuor janar-qershor 2025. Vazhdojmë me piken 5 të rendit të ditës,

-Shqyrtimi i Raportit të Auditimit për Pasqyrat Financiare Vjetore të Komunës së Skenderajt për vitin 2024, me Nr.04-47-1123/1, i datës 26.06.2025, si dhe Plani i veprimit për zbatimin e rekomandimeve të auditorit të jashtëm, Nr. 04-052/01-0026963/25, i datës 09.07.2025, (Raporton **Drejtori i DBF-së, Ismet Aliu;** Raportit të Auditimit për Pasqyrat Financiare Vjetore të Komunës së Skenderajt për vitin 2024, një raport që ka përfshirë një gjendje të vërtetë pas auditimit në dy periudha 9 muor dhe 3 muor dhe i shndërruar në një raport final. Të gjeturat janë të shënuar me A, B dhe C, me A janë të gjeturat të reja, me B janë të gjeturat e përsëritura, dhe me C janë të gjeturat pjesërisht të përsëritura, të gjitha këto të gjetura e kanë edhe rekomandimin, pas këtij raporti kryetari e ka formua grupin punues i cili e kanë bërë planin e implementimit të këtyre

rekomandimeve, që janë përcaktuar përgjegjësit për këto të gjetura se si të veprojmë pastaj dhe me i përmissua këto të gjetura. Pas planit të implementimit komuna është e obliguar që të raportoj të ZKA për implementimin e këtyre të rekomandimeve dy herë në vite, që është deri me 30 shtator ti eliminoj dhe të shkojë drejt permisimit.

Kryesuesja: E hapë debatin, fjalën ja kaloj:

Afrim Kabashi-NSD: Opinioni i auditimit të pika, gjetjet dhe rekomandimet që keni thënë 11 rekomandime, 6 janë rekomandime të reja, 4 të përsëritura, dhe 1 pjesërisht i përsëritur, në cilat drejtori bëhen fjalë këto të gjetura, dhe a mund këto të gjetura me u përmissua nga ana juaj?

Hysni Mehani-LVV: Të raporti i auditimit, drejtor, shpenzimet në vlerë 937,133.00€, janë paguar dhe janë regjistruar në kategorinë ekonomike jo adekuate, tash kjo tregon që keni dështua në planifikim të shpenzimeve dhe gati 1 milion janë në kategorinë jo adekuate? Tjetra, keni arritur në 16% e keni bërë verifikimin e pronave të tatueshme, e minimumi ka qenë 20%? Sipas raportit në vitin 2024 janë paguar prej investimeve kapitale 74.976.00€, ndërkohë ne e pame me herët që 2,400,000.00€ të instituti GAP thotë që janë paguar për kontratën kolektive ku janë marr pjesa tjetër? Dhe këtë 35,000€ a e keni gjete që e ka pagua thesari nga vendimet gjyqësore dhe komuna nuk ka arritur të siguroj lenden, a e dini kujë i kanë shkua këto mjete? Të kontratat publike për riparimin, mirëmbajtjen e rrugëve, lumenjve, Klinë të Epërme, Prekaz, Turiqec, Polac, Runik Rezallë e re, vlera 1,400,000.00€ ishin realizuar në vlerën e planifikuar, megjithatë shpenzimet e planifikuar për kategorinë e parë të peshës në 65% pra ishin realizua në vlerë 1,207,898.00€, pra 300 mijë€ me shume që i keni planifikuar. Me tutje kategoria 3 në peshë 3% apo 42 mijë€, nuk ishte realizua fare, derisa kategoria 2 në peshë 7% apo 98 mijë€ ishin realizuar vetëm 0.7% apo 6,749€ pra i keni shpenzuar paret në pjesën e parë të projektit dhe pjesa tjetër ka mbetur. Diku 436 mijë€ i keni tarifet për vendime gjyqësore e prapë po flasim për mos respektim të kriterëve që kanë të bëjë me subvencione. Po a mundesh me ma shpjegua këtë çështje perse nuk po mundesh me i mbrojtë këto 436,423.00€ që po i marrin vendimet gjyqësore? Sepse unë e di këtu është një avokat që i ka këto lende në gjykatë, e ka lidhje me kryetarin, a është kjo arsyeja që po doni me ja dhënë ati paret apo cila është arsyeja?

Kryesuesja: Fjalën ja kaloj:

Drejtori i DBF-së, Ismet Aliu: Sa i përket të gjeturave unë i kam përmendur në raporte, së kanë e atakon ky raporte është Plani i veprimt që është në fund të këtij raporti që janë të paraqitura drejtorit përkatëse që ka me raportua deri me 30 shtatorë për implementimin e tyre. Të tatimi në pronë një realizim prej 16% i verifikimit të pronave ekzistuese, brenda vitit të verifikohen pronat ekzistues dhe ne nuk kemi mundur me realizua këtë planë, dhe megjithatë nuk do të thotë nuk u realizua ky planë dhe nuk janë të dhënat e sakta, për arsye ne obligohemi me i verifikua gjitha shtëpitë, pronat, dhe nuk do të thotë që ka me pas ndryshime kaq shume mungesa e kapaciteteve zyrtare dhe është rritur në 16% me stafin ekzistues për arsye së janë mbi 12,500 prona në komunën tonë. Të pagesa e vendimeve gjyqësore vitin e kaluar janë paguar 2,455,000.00€, pjesa me e madhe është marrë nga kategoria e pagave, nga projektet kapitale dhe pastaj nga kategoritë tjera.

Kryesuesja: Dikush tjetër, nëse nuk ka shkojmë në votim, Konstatohet me (18) vota për, (8) kundër dhe (0) abstenim përkrat Shqyrtimi i Raportit të Auditimit për Pasqyrat Financiare Vjetore të Komunës së Skenderajt për vitin 2024.

Vazhdojmë me piken 6 të rendit të ditës,

-Propozim-vendim për Plotësim ndryshimin e Rregullores Nr. 01-110/01-0025382/22, e datës 06.06.2022, për Taksa, Tarifa, Ngarkesa dhe Gjoha në Komunën e Skenderajt, me Nr.02-110/05-0029514/25, e datës 22.07.2025, (Raporton);

Drejtori i DBF-së, Ismet Aliu; Propozim-vendim për Plotësim ndryshimin e Rregullores Nr.01-110/01-0025382/22, e datës 06.06.2022, për Taksa, Tarifa, Ngarkesa dhe Gjoha në Komunën e Skenderajt, është propozuar që një nen i kësaj rregullore të Ndryshohet dhe plotësohet paragrafi 7 i nenit 5 të rregullores bazë, i cili formulohet si në vijim: Nga taksa për automjete lirohen familjet e ngushta të dëshmorëve, familjet e ngushta të viktimave civile, invalidët e luftës (personalisht), veteranët e luftës (personalisht) dhe personat me aftësi të kufizuara (personalisht). Në familjet e ngushta përfshihen: Prindërit, bashkëshorti ose bashkëshortja, dhe fëmijët. Lirimi bëhet në bazë të prezantimit të dëshmisë (dokumenti bëhet fotokopje dhe i bashkëngjitet kërkesës) dhe në këto raste zyrtari për pagesa lëshon fletë-pagesa me vlerën zero (0), duke i' bashkëngjitur dëshminë.

Kryesuesja: E hapë debatin, fjalën ja kaloj:

Naser Bajraktari –IDEAL: Se pari kryesuese duhet me kërkua falje asamblistëve të kuvendit, pasi që në seancën e kaluar, Abdullahi këtë pikë e ka propozua për futjen në rend dite, dhe me dashje a pa dashje keni konstatuar së nuk kalon kjo pikë, ku me vota të shumicës kjo pik ka kaluar. Andaj Lista Ideal, këtë pikë që e ka propozua seancën e kaluar e përkrah.

Kryesuesja; Unë mendoj së nuk kam për çka me kërkua falje, së tu u bazua në LVL, dhe rregulloren e kuvendit, se cili anëtar i kuvendit që propozon diçka duhet shumica e thjesht e kuvendit që i bie 16 vota pro, që propozimi i Abdullahit i ka marr 13 vota për, 12 kundër, që kanë qenë gjithsej 30 anëtar të pranishëm dhe e kemi sqaruar gjithçka me ministrin dhe jemi në rregull, dhe nuk kam arsye me kërkua falje, sot e keni si pike të rregull në këtë seancë, fjalën ja kaloj;

Kryetari i komunës, Fadil Nura: Besoj që e keni të qartë, dhe nuk ka nevojë për kërkim falje askush sepse kjo pikë ka kërkuar procedurë dhe ka dalë në diskutim publik për dy javë, dhe nëse nuk e kishim respektua këtë procedurë ministria na kish kthye të pa ligjshme. Po unë e kam edhe një propozim me shtua në këtë rregullore sepse komisionit i ka ik, Kategorinë e familja e ngushtë e të zhdukurit (të pagjeturit) të UÇK-së, familja e ngushtë e të zhdukurit (pagjeturit) civil, propozoj që në kuadër të kësaj mi shtua edhe këto dy kategori sepse mundet me u ndje si familje të diskriminuara.

Kryesuesja: Shkojmë në votim për propozimin e Kryetarit që të shtohen edhe këto: Familja e ngushtë e të zhdukurit (të pagjeturit) të UÇK-së, dhe familja e ngushtë e të zhdukurit (pagjeturit) civil, Konstatohet me (28) vota për, (0) kundër dhe (0) abstenim miratohet propozimi i Kryetarit. Vazhdojmë me miratimin e pikës 6, Konstatohet me (28) vota për, (0) kundër dhe (0) abstenim miratohet Propozim-vendim për Plotësim ndryshimin e Rregullores Nr. 01-110/01-0025382/22, e datës 06.06.2022, për Taksa, Tarifa, Ngarkesa dhe Gjoha në Komunën e Skenderajt, me Nr.02-110/05-0029514/25, e datës 22.07.2025, me propozimin e kryetarit.

Vazhdojmë me piken 7 të rendit të ditës,

-Propozim-vendim për Themelimin e Poliklinikës Specialistikë në kuadër të QKMF-së në Komunën e Skenderajt, me Nr.02-351/01-0026564/25, të datës 10.07.2025, (Raporton);

U.d. i Drejtorit të QKMF-së në Skenderaj, Ilir Havolli; Fjala përshëndetëse, duke u bazuar në nevojat e shtuar për shërbime specialistikë mjekësorë në komunën ton, ne e kemi dërgua një kërkesë për themelimin e poliklinikës specialistikë, dhe sot kësaj kërkesë, po ja shtojmë edhe një kërkesë për hemodializës në kuadër të kujdesit shëndetësor publik.

Arsyetimi i kësaj kërkesë është, numri i lartë i specialistëve duke u bazuar në vitin 2024 kemi gjithsej 143,909.00 vizita mjekësorë nga këto janë 16,167 referime specialiste, dhe 3937 referime spitalore, pra gjatë këtij 6 mujori kemi 65,757 vizita mjeksore nga këto janë 2435 janë referime specialiste dhe 1849 referime spitalore. Në komunën ton kemi 9 raste me hemodializë, ku i kemi dy autoambulanca, ku njëra brenda muajt i realizon 2800km dhe tjetra 3000km dhe ne total brenda muajt 600km, një kosto financiare e lartë.

Kryesuesja: E hap debatin, fjalën ja kaloj:

Hysni Mehani-LVV: Në parim jam pro kësaj, po qysh inkorporohet kjo në suaza të kujdesit parësor shëndetësor, në cilin objekt kanë me u ofrua këto shërbime.

U.d. i Drejtorit të QKMF-së në Skenderaj, Ilir Havolli; Nga kjo asamble komunale kërkohet miratimi i këtij vendimi dhe pastaj obligohet kryetari i komunës me një shkresë që ti drejtohet MSH, pastaj ministria nxjerr një vendim për lejimin e ofrimit të këtyre shërbimeve shëndetësore pastaj fillon implementimi i saj, dhe pastaj fillon lidhja në mes të komunës me shërbim spitalor klinik universitar të Kosovës. Këtu buxheti i komunës është zero, komuna mund të asistoj në gjetjen e ndonjë lokali për vendosjen e kësaj klinike, sepse vetëm hemodializa do të jetë shërbim i veçantë dhe do të ketë hapësirë të veçantë, i gjithë investimi kapital do të jetë nga ministria e shëndetësisë.

Besart Rrecaj-PDK: Drejtor, thatë keni me themelua klinik po pa objekt, qysh kanë me na ofrua shërbime pa pas objekt? Dhe kur të behet kjo klinik specialistike të ofrohen gjitha shërbimet duke i ofruar dhe operacionet të cilët qytetaret tan i kryen në Mitrovicë dhe Prishtinë, nëse po a keni menduar në aspektin financiar me përllogaritë edhe komunën apo vetëm ministrinë, sepse është një fushë që kam dëshirë të behet, po realisht nuk kam shume njohuri?

Naser Bajraktari-IDEAL: Drejtor askush nuk është kundër formimit të një poliklinike po kemi koleg doktor në asamble që janë profesionist, çka mendojnë këta për këtë poliklinikë?

Hysni Mehani-LVV: Sinqerisht kisha dashtë mendimin e dy doktorëve që me na ndihmua në këtë pjesë. Dhe ka çështje të pa qarta këtë poliklinikë a je tu dashtë me shti në kuadër të regjionit të Mitrovicës, apo direkt me Prishtinën?

Kryesuesja: Fjalën ja kaloj:

Armir Sejdiu-PDK: Fjala përshëndetës, iniciativa e drejtorit të QKMF-së, z.Havolli është mjaft e mirë edhe e mirëseardhur, po edhe realizimi i kushteve, objekti dhe gjitha të tjera janë të mundshme, po sigurimi i resurseve humane është e pamundshme sidomos stafi specialisteve, ju gjithë e dini se spitali i Mitrovicës është tu vuajtur për specialist, dializën në Mitrovicë e mban vetëm një nefrolog specialist ku kryhen dializa dhe kemi telashe të jashtëzakonshëm në realizimin e punës aty. Të realizohet hemodializa në Skenderaj ish kanë diçka e jashtëzakonshëm po është e pamundur, poliklinikë nuk munden me u shtri pacientet me qëndrua sepse duhet me pas mjek kujdestar me i përcjell, po në poliklinik merren shërbime ambulatorë dhe do të merren vetëm vizita specialistike, nuk do të ketë operacione po për me realizua do të jetë një sfidë shume e madhe sepse ka mungesë të specialisteve, një specialist nuk pranon me ardh në Mitrovicë leje në Skenderaj, dhe është diçka e pamundur të realizohet.

U.d. i Drejtorit të QKMF-së në Skenderaj, Ilir Havolli; Kjo poliklinikë nuk do të jetë në regjionin e Prishtinës as Mitrovicës po do të jetë direkt e lidhur në menaxhim me ShSKUK-së, pra i gjithë implementimi i këtij procesi shkon nga ShSKUK-ja, kjo poliklinikë do të jetë e qytetareve dhe do të jetë e komunës. Podujeva dhe Rahoveci e kanë realizua, pse ne nuk mundem, ne se pari te marrim vendimin e kuvendit pastaj aprovimin nga MSH. Ne do të kemi sfida në realizime, po çdo dështim rrugës për mua është sfidë për investim, dështim është nëse këtu dështojmë e nuk vazhdojmë tutje.

Kryesuesja: Fjalën ja kaloj:

Ali Lutfiu-PDK: Fjala përshëndetëse, fillimisht as një punë nuk mundet me u krye nëse nuk fillon, që mundet me kanë e mirë edhe me fillua edhe me u përkrah, pa marr parasysh edhe nëse është me kohe fushate, kur është për interes të qytetarëve duhet me u përkrahe. Unë nuk mendoj që është e pamundur ky projekt dhe mendoj që është i mundshëm edhe shume bile, deri sa Rahoveci dhe Podujeva e kanë realizua pse ne nuk mundem me realizua, dhe kisha kërkuar përkrahje drejt realizimit të këtij projekti.

Ragip Durmishi-PDK: Fjala përshëndetëse, unë ju kisha inkurajua të gjithëve të votoni propozimin dhe të kalojmë një hap tutje, po vështirësi ka, edhe në aspektin financiar edhe resurse njerëzore, po kjo poliklinikë është shumë e mirë edhe e mirëscardhur për qytetare edhe është e domosdoshme, po si kuvend është mirë me kalua, pastaj të kalohet nëpër procedura tjera.

Kryesuesja; Replikë 1 min.

Besart Rrecaj-PDK: Drejtor unë e votoj me dy duart, mirëpo ne ata e dimë kur të shkon në Ministri, që u nistë prej Podujeve, prej sa të është kjo qeveri në pushtet nuk ka me kalua ky vendim, dhe nëse ndërrohet qeveria kalon.

Naser Bajraktari-IDEAL: Nëse e dëgjuat diskutimin e doktor Amirit, i cili është profesionist i kësaj fushe që tha mundësit janë zero dhe unë i besoj njerëzve profesionist dhe jo njerëzve që nuk janë profesionist. Drejtori tha të nxjerrim njëherë këtë vendim pastaj, e marrim vendimin prej ministrisë tani e gjejmë pronën, po me gjete atë pronë krejt i kanë marrë s'ka kundër as një pëllëmbë nuk është.

Abdulla Gashi-IDEAL: E përgëzoj doktorin Amir se shumë saktë e potencojë.

Floriana Halili-LVV: Fjala përshëndetëse, atëherë teknikat po na dalin me të mençur si doktoratë, desha me pyet doktor Amirin pse këna nevojë për shërbime ambulatorore për me krijuar poliklinikë?

Kryesuesja: Fjalën ja kaloj:

Armir Sejdiu-PDK: Pse kemi nevojë për poliklinikë e cekti drejtori i QKMF-së sepse ajo është e mirëscardhur sepse kryhen shërbime ato që i merrni në Mitrovicë i merr ato shërbime këtu, po problemi kryesorë është të specialistet.

Ali Lutfiu-PDK: Floriana në rend të parë këtu nuk kemi ardhur si specialist as si infermier, po kemi ardhur si asamblist dhe se cili ka drejtën me dhënë mendimin e vetë.

Mentor Mehmeti-PDK: Fjala përshëndetëse, edhe në KPF, kemi debatuar rreth kësaj çështje se shumë qytetarë kanë kosto të mëdha me shkua në qytetin e Mitrovicës neper poliklinika private, të vazhdojmë me procedura, mos të vazhdojmë me inate, sepse qytetari ka nevojë çdo ditë.

Kryesuesja: Me kaq mbyllet debati, shkojmë në votim, Konstatohet me (23) vota për, (0) kundër dhe (0) abstenim, miratohet Propozim-vendim për Themelimin e Poliklinikës Specialistikë në kuadër të QKMF-së në Komunën e Skenderajt.

Vazhdojmë me pike 8 të rendit të ditës:

-Propozim-vendim për miratimin e raportit përfundimtar, Nr. 09-052/01-0026407/25, i datës 07.07.2025, i hartuar nga komisioni komunal për vlerësimin e dëmeve, si pasojë e fatkeqësive natyrore si (era, zjarri), për periudhën janar-qershor 2025, me Nr.02-052/01-0027799/25, i datës 11.07.2025, (Raportin);

Drejtori i DSHP-së Alban Shala; Fjala përshëndetëse, para vetes e keni Propozim-vendim për miratimin e raportit përfundimtar i hartuar nga komisioni komunal për vlerësimin e dëmeve, si pasojë e fatkeqësive natyrore si (era, zjarri), për periudhën janar-qershor 2025, Dëme janë shkaktuar në bujqësi dhe në ekonomi familjare, në territorin e Komunës së Skenderajt, komisioni i ka vlerësua të dëmtuarit në vlerë totale prej 217,481.49€, listën e të dëmtuarve e keni para vetes, kush ka pyetje jam këtu për përgjigje.

Kryesuesja: E hapë debatin, fjalën ja kaloj:

Hysni Mehani-LVV: Drejtor këto ngricat që e ka rrokë nipin e Sami Lushtakut vlere, 45,226.57€ në cilën pronë e ka rrokë, dhe qysh e rroki veç këta e nuk i rroki Kodralit, Mehovit, Jashart, Latift po e rroki veç nipin e Sami Lushtakut i cili ka marrë edhe tender 400 mijë€, a mundesh me na tregua qysh e rroki veç këta ngricat? Në raportin që e keni bërë për vlerësimin e dëmeve për vërshimet e janarit 39 vetura nuk ju dihet pronari ose janë të pasakta në atë çka e keni kërkuar, dhe 407 mijë€ janë që i keni dërguar pa pronar që nuk i dihet pronari ose të dhënat janë të pasakta. Një veturë e

Bekim Nures, shpresoj të mos jetë shoferi i Fadil Nures është vlerësuar 220mijë€, kur ja ka kthye AME-ja keni thënë me falë së gabim është 22mijë€, 11mijë€ Shahin Tahirit vetura e drejtorit të shëndetësisë, Isë Dobres 30mijë€, Mihane Bektesit 70mijë€ anëtarës së PDK-së ja keni vlerësuar një gjenerator, dhëndrit të Sami Lushtakut 470mijë€, vajzës së ti 94mijë€ dhe Enver Mules 300mijë€, tash qysh ngricat dhe vërshimet po ju rrokin veç juve që jeni në PDK dhe në pushtet. Dhe kisha kërkuar që Osman Bytyqi me u largua prej kësaj kategorie se njërit ju ka kall shtëpia. Dhe tjetra me kesi vlerësimesh dhe keq klasifikimesh edhe me këto tendenca ka i qon 39 vetura që nuk i dihet pronari normal që nuk pagune qeveria, edhe nuk është e vërtetë që nuk ka pagua sepse 374 familje i kanë marrë mbi 2,200,000.00€ për demet që ju kanë bërë, por kur bëni kesi dallavere normalisht që nuk ju pagunë, ura vet e pranuat 160mijë€ jeni tu i ndërtua me pare të qeveris as një cent nuk e keni të juaji, edhe dilni i thoni qytetarëve që s'po paguan qeveria, nuk është e sinqertë kjo.

Abdulla Gashi-IDEAL: Sa i përket dëmeve, na jemi të gjithë ti ndihmojmë fermerëve dhe qytetarëve, po drejtor është mirë me qenë transparent ku të është në pyetje një vlerësim i tillë. Dhe me sa po shohë njëjtë njerëz tu përfitua dhe janë qëllime politike të afërt me pushtetin e juaj. Dhe sa i përket dëmeve të janarit ka shume kërkesa që nuk dinë çka ka ndodh me demet e automjeteve dhe a i keni rregullua këto çështje të atyre dëmeve që nuk janë bërë hala?

Kryesuesja: Fjalën ja kaloj:

Kryetari Komunës, Fadil Nura: Është mirë mos me fol pa asnjë argument, pa asnjë bazë me thanë 39 vetura s'kanë pronar, me përmend emra si Bekim Nura vetura e ti pa pronar, këto janë spekulime, sepse komisioni veturat i ka evidentua në bazë të librezës së veturës dhe çdo dyshim komisioni i AME-së kanë ardhur për rivlerësim, si p.sh të Enver Mulaj AME-ja e ka rivlerësuar dhe disa raste tjera, dhe ju kam thënë ku të keni dyshime dilni rivlerësone, dhe janë kanë disa gabime teknike i kemi permisuar dhe ja kemi dërguar AME të permisuar.

Drejtori i DSHMS-së, Shahin Tahiri: Hysni në atë kohe nuk jam kanë drejtor, kam qenë në Hekurudha të Kosovës realisht kerri jem është vlerësua prej komisionit tash 11mijë€ tash nuk ta shes me çmime 11mijë€, që mu ka vlerësua, dhe unë atë kerr ende e kam dhe 2 muaj dite ka qëndrua në kran dhe nuk e di çka u prish.

Kryesuesja: Fjalën ja kaloj:

Hysni Mehani-LVV: Po ta lexoj një komunikim zyrtar që e ka be Ismet Aliu me Kastriot Lajqin i nderuar kryesues i komisionit, për demet nga fatkeqësia natyrore, po ju dërgoj edhe një herë demet në vetura pasi që nga komisioni komunal ka rrjedh një gabim teknik Nr. rendor 86 ku shuma prej 220mijë€, duhet të jetë 22mijë€. Po ashtu vlen të theksohet së në 5 raste të identifikuar me shenjen yll në tabele të exelit mungon pronari dhe të dhënat e ti për kompensime, komisioni i ka vlerësuar pavarësisht a ka qenë pronari prezent a jo, ashtu janë edhe 3 raste kur komisioni i ka vlerësuar pa qenë prezent e pa e ditë të kujë janë veturat, ky është komunikim zyrtarë. Dhe krejt çka po thamë unë ti vërtetoj. Është një farë Bleroni i lyp 45mijë€ aji nuk ka as mbiemër e keni dërgua ashtu edhe po thoni s'po paguan qeveria. Thashë ekonomit familjare janë pagua krejt, dhe perse nuk janë pagua demet në bujqësi dhe në biznese janë fajet të ju që nuk i keni vlerësua real.

Kryesuesja: Me kaq mbyllet debati, shkojmë në votim, Konstatohet me (16) vota për, (9) kundër dhe (0) abstenim, miratohet Propozim-vendim për miratimin e raportit përfundimtar, Nr. 09-052/01-0026407/25, i datës 07.07.2025, i hartuar nga komisioni komunal për vlerësimin e dëmeve, si pasojë e fatkeqësive natyrore si (era, zjarri), për periudhën janar-qershor 2025.

Vazhdojmë me pike 9 të rendit të ditës:

Pyetjet e këshilltarëve nën pikat të ndryshme, fjalën ja kaloj

Abdulla Gashi-IDEAL: Pyetjen e parë dhe dytë kam marr përgjigje, 3. Pyetje për Drejtorin e Urbanizmit, z. Driton Mula: I nderuar Drejtor, Rruga "Hasan Feka" në fshatin Llaushë është e shtruar vetëm me zhavorr dhe gjendja e saj po shkakton shumë vështirësi për banorët, sidomos për shkak të pluhurit të madh gjatë muajve të verës. A keni në plan që kjo rrugë të përfshihet në projektet e asfaltimit në të ardhmen e afërt? Banorët kanë nevojë të madhe që kjo rrugë të rregullohet sa më parë.

Kryesuesja: Fjalën ja kaloj:

Drejtorit DUMA-së, Driton Mulaj: Sa i përket rrugës që po e përmend kemi me vazhdua po njëherë s'kemi buxhet.

Kryesuesja: Me kaq mbyllet kjo mbledhje, shihemi në mbledhjen tjetër.

Procesmbajtësi



Kryesuesja e Kuvendit

